



Ministri Pirro Vengu: Shqipëria, një logjistike për operacionet e Aleancës



Ministri i Mbrojtjes Vengu pret ambasadorët e Francës, Britanisë e Bullgarisë

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu zhvilloi takime të veçanta me ambasadorët e Francës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Bullgarisë. Rijetëzimi i Industrisë Ushtarake dhe modernizimi i Forcave tona të Armatosura ishin temat kryesore të bisedave me përfaqësuesit diplomatikë të këtyre vendeve.

Në takimin me ambasadorin e Francës znj. Catherine Suard, ministri Vengu shprehu interesin për të shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit në rijetëzimin e Industrisë Ushtarake, modernizimit si dhe zgjerimin e mundësive në fushën e Edukimit dhe Trajnimit.

Gjatë bisedës me ambasadorin britanik z. Nick Abbotts, ministri i Mbrojtjes e informoi për zhvillimet e fundit në fushën e Industrisë së Mbrojtjes si dhe proceset e modernizimit. Situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe shqetësimi për ndërhyrjet dhe aktivitetet hibride nga aktorët e huaj në rajon ishte një tjetër temë e bisedës.

Në këtë takim, ministri Vengu dhe ambasadori britanik vlerësuan maksimalisht stërvitjen ushtarake të përbashkët “Corridor VIII Response”, që po zhvillohet në territorin shqiptar, në interes të rritjes së ndërveprueshmërisë,



lëvizshmërisë ushtarake dhe linjave të furnizimit në rajonin e Europës Juglindore.

Ndërsa në takimin me ambasadorin e Bullgarisë në Shqipëri, z. Ivaylo Kirov u vlerësua kontributi i trupave shqiptarë në Grup-Batalionin e NATO-s në Novo Selo. Ministri Vengu dhe ambasadori bullgar ranë dakord të vijojnë ndërveprimin e përbashkët në mbështetje të promovimit të Korridorit VIII, si një nyje e rëndësishme lidhjeje sigurie mes Adriatikut dhe Detit të Zi.



Zëvendësministri Dorian Tola pret komandantin e Forcës Detare të Bullgarisë, nënadmiralin Kiril Mihaylov

Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Dorian Tola priti në një takim komandantin e Forcës Detare të Bullgarisë, nënadmiralin Kiril Mihaylov. Gjatë takimit u diskutua për marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet dy vendeve në të gjitha nivelet në fushën e Mbrojtjes, si dhe mbi mundësitë e intensifikimit të tyre.

Nënshkrimi i Letrës së Qëllimit nga të dyja vendet, së bashku me Italinë dhe Maqedoninë e Veriut ka hapur rrugën e bashkëpunimit në kuadër të Korridorit VIII. Ky korridor ka një rëndësi strategjike të dyfishtë, jo vetëm si një rrugëkalim i sigurt për lëvizshmërinë e trupave ushtarake aleate, por edhe për zhvillimin ekonomik të rajonit, duke mundësuar lidhje më të shpejta dhe më efikase ndërmjet vendeve.

Zëvendësministri i Mbrojtjes theksoi gjithashtu rëndësinë e Portit të Porto Romanos si porta hyrëse e këtij korridori. Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për Industrinë e Mbrojtjes, përpjekjet e Shqipërisë për rijetëzimin e saj dhe përvojat e Bullgarisë në këtë drejtim, veçanërisht në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve detare.

Stërvitja “Austere Wolf - 24”, gjeneralmajor Kingji: Stërvitja e përbashkët me forcat britanike teston kapacitetet dislokuese të forcës strategjike rezervë të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, nga takimi i Ditës së Vizitorëve të Shquar u shpreh se zhvillimi i kapaciteteve portuale të vendit tonë do të adresohet nëpërmjet investimit në portin e ri të Porto Romanos.

Në fjalën e tij, në Ditën e Vizitorëve të Shquar (Distinguished Visitors Day) të stërvitjes së përbashkët mes trupave shqiptare dhe britanike “Austere Wolf - 24”, Kingji u shpreh se: “Përkeqësimi i mjedisit të sigurisë, si rezultat i luftës së paprovokuar të Rusisë në Ukrainë, nxiti Aleancën të rivlerësojë strategjinë e shkurajimit dhe mbrojtjes dhe të vërë në funksion planet rajonale, të cilat të harmonizuara me planet kombëtare të vendeve aleate, përbëjnë mbrojtjen më gjithëpërfshirëse të Aleancës në dekada”.

Kingji theksoi se, element i rëndësishëm në suksesin e këtyre planeve rajonale është mbështetja, lëvizja e shpejtë dhe e sigurt e forcave dhe mjeteve nga perëndimi në drejtim të kufirit lindor të Aleancës.

“Në këtë drejtim, - shtoi Kingji, - përveç kapaciteteve të këtij korridori, ‘Austere Wolf - 24’ do të shërbejë si një mundësi e mirë për të vlerësuar dhe përmirësuar procedurat dhe kapacitetet e vendit pritës të Shqipërisë, në kuptimin e infrastrukturës, mbështetjes dhe magazinimit.

Situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor është e lidhur ngushtë me atë të zonës euroatlantike, ndaj, - shtoi Kingji, - kjo stërvitje e përbashkët merr një rëndësi akoma më të madhe pasi do të testojë edhe kapacitetet dislokuese të forcës strategjike rezervë të NATO-s”.

Kingji nënvizoi se, përveç rishikimit të planit kombëtar të mbrojtjes, Shqipëria ka shprehur



gatishmërinë për një rol më aktiv për mbështetjen e planit rajonal për Evropën Juglindore.

Kingji, gjithashtu, vuri theksin tek investimi në portin e ri të Porto Romanos. “Duke marrë në konsideratë kapacitetet dhe fluksin e lëvizjes që ofron Korridori VIII, evidentohet domosdoshmëria

për zhvillimin e kapaciteteve portuale, të cilat do të adresohen nëpërmjet investimit në portin e ri të Porto Romanos. Ky port do të ofrojë kapacitete debarkimi dhe strehimi për njësitë deri në nivel brigade dhe shërbime mirëmbajtje, furnizimi dhe magazinimi”, - tha Kingji.

Kingji shtoi se: “Mundësitë e ofruara nga ky port, përforcohen nga baza ajrore e Kuçovës, e cila do të shërbejë si qendër për dislokimin, trajnimin dhe aktivitetet e forcave tona ajrore, si dhe do të mbështesë operacionet dhe stërvitjet e NATO-s”.

Stërvitja e Përbashkët “Austere Wolf - 24”, ministri Vengu: Shqipëria, një logjistike për operacionet e Aleancës

U zhvillua Dita e Vizitorëve të Shquar, në stërvitjen e përbashkët ushtarake mes trupave shqiptare dhe britanike “Austere Wolf - 24”, pjesë e stërvitjes më të madhe “Corridor VIII Response”.

Të pranishëm në këtë ditë ishin ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, i dërguari special i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Lord Stuart Peach, ambasadorë dhe atashë ushtarakë.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu theksoi se kjo stërvitje është edhe një përgjigje ndaj realitetit të sigurisë në rajonin tonë.

“Këto ndërveprime krijojnë një shembull të qartë të angazhimit dhe fokusit të vendeve tona në përmirësimin e kapaciteteve tona, gatishmërisë operationale dhe infrastrukturës si një parakusht për këtë gatishmëri. Vendndodhja gjeografike mes dy vendeve tona ndoshta nuk është e afërt në koordinata, por ajo bëhet e papërfillshme, kur bëhet fjalë për interesat e përbashkëta strategjike të NATO-s, prandaj edhe ‘Corridor VIII Response’ tregon jo vetëm rritjen e aftësive tona ushtarake, por edhe rolin e Shqipërisë si një nyje logjistike për operacionet aleate”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes.

“Në Samitin e NATO-s në Uashington, vendi ynë, bashkë me Bullgarinë, Italinë dhe Maqedoninë e Veriut ndërmorën një hap të rëndësishëm me qëllim lehtësimin e lëvizshmërisë ushtarake të trupave të NATO-s përgjatë Korridorit VIII. Shqipëria konfirmon kështu përkushtimin e plotë për të çuar përpara planet e zhvillimit infrastrukturor dhe në mënyrë të paevitueshme këtu del në skenë infrastruktura portuale në Durrës dhe në Kompleksin Durrës - Porto Romano, pjesë jetike për të hyrë në Korridorin VIII, pjesë jetike për një logjistikë për një lëvizshmëri operationale të rrjedhshme në të gjithë rajonin.

Rëndësia e dytë e kësaj nyje logjistike ka të bëjë me ‘zinxhirët e furnizimit të rajonit’, - u shpreh më tej, ministri Vengu.

Sipas ministrit të Mbrojtjes: “një mbrojtje moderne kërkon një infrastrukturë të fortë dhe të mirëmbajtur e ne po punojmë fuqimisht në këtë aspekt. Misioni ynë është që të forcojmë sigurinë në një kohë kur Evropa Juglindore është vazhdimisht nën kërcënimin e influencave malinje që kërkojnë të destabilizojnë rajonin. Për të arritur këtë duhet të rrisim edhe më shumë nivelin e bashkëveprimit dhe bashkëpunimit me aleatët tanë”.

Nga ana e tij, i dërguari special i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Lord Stuart Peach vlerësoi bashkëpunimin me Forcat e Armatosura shqiptare në stërvitjen “Austere Wolf - 24”, ndërsa e cilësoi këtë aktivitet faktor në forcimin e masave për rritjen e sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Lordi Stuart Peach tha se: “Me luftën që po ndodh në Ukrainë, është e rëndësishme të kujtojmë rëndësinë e sigurisë në Evropë”. Peach foli për rëndësinë strategjike të Korridorit VIII, që lidh rrugët, portet, infrastrukturën dhe siç u shpreh ai, është shumë i rëndësishëm, pasi bën të mundur që Aleanca të lëvizë me shpejtësi.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, teksa falënderoi forcat britanike për angazhimin në



këtë stërvitje të përbashkët tha se: “Kjo stërvitje e përbashkët merr një rëndësi akoma më të madhe, pasi do të testojë edhe kapacitetet dislokuese të forcës strategjike rezervë të NATO-s - Strategic Reserve Force”.

Stërvitja e përbashkët “Austere Wolf - 24”, pjesë e stërvitjes më të madhe “Corridor VIII Response” do të zgjasë deri më 7 tetor dhe do të zhvendoset edhe në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë.



Ministri Vengu pret të dërguarin special të Britanisë për Ballkanin Perëndimor, Lord Stuart Peach: Shqipëria, më shumë investime në infrastrukturën mbështetëse të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu priti në një takim të veçantë të dërguarin special të Mbretërisë së Bashkuar në Ballkanin Perëndimor, Lord Stuart Peach, i cili erdhi në Shqipëri në kuadër të Stërvitjes së Përbashkët “Austere Wolf - 24”. Ministri Vengu dhe Lord Stuart Peach vlerësuan maksimalisht ndërveprimin mes trupave shqiptarë dhe britanikë në stërvitjen “Corridor VIII Response”.

Gjatë bisedës me zyrtarin e lartë britanik, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, diskutoi rreth situatës së sigurisë në rajon përfshirë edhe Veriun e Kosovës, për të cilën Shqipëria jo vetëm mirëpret vendimin e Aleancës për shtimin e trupave atje, por edhe ka rritur praninë e ushtarakëve shqiptarë në misionin e KFOR. Sipas ministrit të Mbrojtjes: “...si vend anëtar i NATO-s, pozicioni i privilegjuar gjeografik i vendit tonë na angazhon për të investuar më tej në infrastrukturën mbështetëse për Aleancën”. Ministri Vengu



theksoi gjatë bisedës me zyrtarin e lartë britanik se: “Në Korridorin VIII po punohet intensivisht në disa lote, për të vijuar më tej me projektin madhor të portit në Porto Romano, një pjesë e të cilit do të jetë i dedikuar për përdorim ushtarak”. Po ashtu,



ministri Vengu e njohu Lord Peach me hapat që Shqipëria ka ndërmarrë për rritjen e Industrisë Ushtarake, duke ftuar për investim dhe bashkëpunim çdo agjenci apo kompani britanike.

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë viziton Detashmentin e Avionëve pa Pilot të FAj



Në kuadër të përgatitjeve të fundit për hapjen dhe zhvillimin e vitit të ri akademik 2024-2025, personeli drejtues dhe pedagogjik, krahas praktikave mbështetëse dhe hedhjes së programit përfundimtar, zhvilloi vizitë njohëse/akademike në Detashmentin e Avionëve pa Pilot, Kuçovë.

Baza Taktike Ajrore e NATO-s, një investim i sapo përfunduar nga NATO dhe Ministria e Mbrojtjes, përbën një kapacitetet të ri operacional dhe përmban një komponent të rëndësishëm për t'u njohur dhe vlerësuar.

Personeli i Kolegjit, i drejtuar nga komandanti i tij, gjeneral brigade Ylli Pulaj, u prit nga kolonel Ardian Kuli komandant i Bazës Ajrore dhe major Elio Buçka komandant i Detashmentit të Avionëve pa Pilot, të cilët e njohën personelin pedagogjik me infrastrukturën, kapacitetet operationale, investimet e fundit të NATO-s dhe Ministrisë së Mbrojtjes në Bazën Taktike Ajrore të NATO-s, si dhe operationet që kryhen nga ky detashment në kuadër të NATO-s.

Në këtë kuadër u realizua një demonstrim ajror stërvitor me dy helikopterë ("Blackhawk" dhe "Cougar") si dhe prezantimi i avionëve pa pilot



UAV, i cili u ndoq me interes nga stafi pedagogjik i Kolegjit. Kjo vizitë u realizua me qëllim njohjen nga afër të aspekteve operationale për përfshirjen dhe integrimin e tyre në procesin mësimor.

Këtë vit akademik, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë do të hapë dyert për katër programe studimi: Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH), Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSH), Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) dhe Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM).



Anija "Oriku" zhvillon stërvitje të përbashkët me anijen gjermane "Pegnitz" (M1090)

Anija "Oriku" e Forcës Detare dhe ekuipazhi i saj, pjesë e misionit të NATO-s në detin Egje, zhvilluan një stërvitje të përbashkët në ujërat ndërkombëtare, me anijen gjermane "Pegnitz" (M1090).

Në këtë stërvitje u zhvilluan seriale stërvitore sipas standardeve të manualeve të NATO në det. Gjithashtu ekuipazhi i anijes "Oriku" testoi aftësitë operationale dhe ato ndërvepruese me anijet dhe ekuipazhet aleate.

Komandanti i CTU, Kapiteni Günther Brasel zhvilloi një vizitë në anijen "Oriku" gjatë së cilës theksoi se këto stërvitje janë një mundësi për ndërveprimin e efektivë të anijeve aleate



si dhe shprehu vlerësimet maksimale për punën e deritanishme të anijeve shqiptare gjatë kryerjes së misioneve në rajonin e përgjegjësisë, në realizimin e detyrës në shërbim të Aleancës.

Shefi i Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes viziton Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë gjeneral brigade Ylli Pulaj priti në takim kortezie shefin e Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes (ODC-Office of Defense Cooperation) nënkolonel Joshua Magnusson.

Gjeneral brigade Pulaj pasi i uroi mirëseardhjen e njohu shefin e zyrës së ODC me misionin, detyrat, strukturën dhe kurset institucionale që zhvillohen gjatë vitit akademik në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, duke u ndalur në bashkëpunimin në fushën e edukimit ushtarak me qëllim rritjen e numrit të personelit në trajnime, kurse, seminare në veçanti për personelin pedagogjik të Kolegjit.

Nga ana e tij, shefi i Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes, nënkolonel Joshua Magnusson falenderoi gjeneral Pulaj për pritjen duke shprehur se ndihet shumë mirë mbi bashkëpunimin deri më tani me FARSH dhe se është i gatshëm të inicioi praktikën për vijimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes.

Takimi u mbyll me fotografi të përbashkët.



Në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua aktiviteti "Recruting and Retention Exchange"

Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak të Forcës Tokësore me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore u zhvillua aktiviteti "Recruting and Retention Exchange".

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja e përfaqësuesve të Komandës së Rekrutimit të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit me reformat dhe ndryshimet në Forcën Tokësore, procedurat e rekrutimit, trajnimit, motivimit dhe mbajtjen e personelit ushtarak në shërbim aktiv.

Në fjalën e mirëseardhjes komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia ndër të tjera vlerësoi kontributin ndër vite që pala amerikane ka dhënë në mbështetje të Forcës Tokësore. Tregues i këtij bashkëpunimi është edhe takimi i sotëm. Nënkolonel Vincent Tirra, drejtuesi i ekipit amerikan, pasi falënderoi komandantin e Forcës Tokësore për mikpritjen, u shpreh i bindur se bashkëpunimi i deritanishëm do të vijojë të jetë po aq i frytshëm edhe në



të ardhmen. Për të pranishmit u paraqit një briefing me procedurat që zbatohen në Forcën Tokësore për sa i takon implementimit të politikave të rekrutimit dhe motivimit për personelin ushtarak, me qëllim vijimin e shërbimit të tyre në Forcat e Armatosura.

Përfundon stërvitja kompaktësuese "Dimali-24" e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut

Përfundoi stërvitja kompaktësuese "Dimali-24" e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut dhe me pjesëmarrjen e një toge këmbësorie nga Forca e Sigurisë së Kosovës, me qëllim testimin e kapaciteteve operationale dislokuese, komandim-kontrollit dhe ndërveprimit.



Gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj pret komandantin e Forcës Detare të Bullgarisë, nënadmiral Kiril Mihaylov

Akademia e Forcave të Armatosura u vizitua nga komandanti i Forcës Detare të Bullgarisë, nënadmiral Kiril Mihaylov, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, ata u pritën nga gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj. Gjatë këtij takimi u fol për arritjet e Akademisë së Forcave të Armatosura, si dhe u diskutuan tema me interes të përbashkët.



AFA rrëmben 3 medalje në maratonën e atletikës

Në maratonën ndërkombëtare të atletikës, të zhvilluar në qytetin e Prishtinës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shumë shteteve si: Kenia, Hungaria, Italia, SHBA-të, si dhe përfaqësues nga i gjithë rajoni, morën pjesë edhe efektivë dhe studentë të Akademisë së Forcave të Armatosura. Në garën e 10 km, major Bledar Mesi zuri vendin e tretë, studenti i AFA-së, Përparim Gashi zuri vendin e katërt në garën 5 km, ndërsa studentja Flora Thaqi zuri vendin e dhjetë në garën 21 km.



Në Komandën Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit EOD niveli III +

Në ambientet e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal) niveli 3+.

Kursi EOD niveli 3+, zhvillohet për herë të parë në strukturat EOD të Forcave të Armatosura dhe përfaqëson nivelin më të lartë të kualifikimit për operatorët EOD, bazuar në programet IMAS (International Mine Action Standard).

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, falënderoi kursantët për përkushtimin dhe entuziazmin për të çuar në një nivel më të lartë njohuritë e tyre profesionale dhe vuri theksin në rëndësinë e jashtëzakonshme që kanë të tilla kurse, të cilat zhvillohen me mbështetjen dhe nën drejtimin e instruktorëve Amerikanë, përfaqësues nga Garda Kombëtare e New Jersey-it dhe nën mbikëqyrjen e ekspertit EOD, përfaqësues i "Golden West", për të ruajtur operacionalitetin e strukturave të Komandës Mbështetëse.

Për më shumë se një muaj, kursantët, efektivë të Batalionit të Xhenios, përvetësuan njohuri teorike dhe praktike për realizimin e detyrave për asgjësimin e pajisjeve eksplozive të improvizuara, për të realizuar analizë teknike të municioneve konvencionale, vendosjen në siguresë të municioneve si dhe asgjësimin logjistik të tyre. Kursi EOD niveli i 3+, krahas



të tjerave shërben dhe për përgatitjen e kursantëve për t'u angazhuar në detyra të instruktorit për kurset e radhës EOD, të cilat zhvillohen në Qendrën Stërvitore.

Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikata pjesëmarrjeje për kursantët, certifikata mirënjohjeje për instruktorët Amerikanë dhe u realizua një foto e përbashkët.



Në QAPN filloi kursi i 82-të Fillestar i Nënoficerit

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve filloi kursi i 82-të Fillestar i Nënoficerit, në të cilin marrin pjesë 38 kursantë. Kursi Fillestar zhvillohet për një periudhë 5-javore me module teorike dhe praktike





INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Letrat shpesh i shkruajmë për të përshëndetur miq e të afërm kudo ndodhen, unë këtë letër po e shkruaj si një rekuem për veten dhe bashkëmoshatarët e mi, pse jo dhe fëmijët tanë, e sigurt që nuk do kuptojnë ose do ju duket si një trill gazetaresk. E megjithatë ky ka qenë realiteti, me të metat dhe bukuritë e veta. Brezit që na përket ne, është ai i të lindurve në fillim të viteve '80. Ne që shtëpitë e blera nga prindërit tanë i shohim sot të kushtojnë tridhjetë apo dyzet herë më shumë. Tani që ka hyrë në modë financimi nëpërmjet bankave jemi aq të zgjuar sa ta kuptojmë që, kush guxon ta blejë këtë shtëpi do paguajë interesat ndaj bankës të paktën deri sa ai vetë të jetë bërë gjysh... (nëse e arrin këtë status). Luftën partizane, ne, nuk e kemi bërë, as zbritjen në Hënë nuk e kemi parë, nuk kemi jetuar miqësinë me popullin rus ose kinez dhe kujtesa jonë historike fillon pak a shumë me Botërorin USA 1994. Duke qenë se nuk kemi bërë ndërtimin e hekurudhave dhe aksionet e zboret, shpesh na thonë që s'dimë se çfarë është lodhja... askush prej nesh nuk mërzhitet se na thonë edhe që nuk kemi ideale, sepse lexojmë shumë më pak libra se prindërit tanë (por shumë më shumë fëmijët tanë të viteve 2000).

Të shumtën e rasteve 'Plaku i Vitit të Ri' nuk na sillte çfarë dëshironim, por sot e kësaj dite më të mëdhenjtë na përsërisin se ne i kemi patur të gjitha, edhe pse janë ata më të vegjlit se ne, që me të vërtetë i kanë të gjitha (por atyre askush nuk iu thotë gjë).

Jemi brezi i fundit që luajtëm me peta, me karroca, kukulla leckash të sajara vetë me pe dhe gjilpërë (jo kukulla Barbi me flokët e artë) dhe në të njëjtën kohë të parët që mësuam të luajmë me Play-station, (kush nga ne nuk i ka urreyer të paktën një herë mustaqet e Mario Bross) dhe në të njëjtën kohë të parët që panë filmat vizatimorë me ngjyra në televizor dhe shkëmbyen makinat Turbo.

Kemi veshur pantallona të gjëra, të ngushta, kauboj, të grisura dhe të zhubrosura (sepse moda kështu urdhëronte). Tutat e para që kemi veshur ishin blu me vija të bardha por në rrugë s'para i vishnim edhe pse ishin të rehatshme, sepse kjo donte të thoshte se ti ishe 'rural'.

E kemi kaluar shkollën fillore duke shkuar atje edhe të shtunën... Eh po, po me çantën në shpinë dhe me itinerarin shkollë-shtëpi pa devijime rrugës me orë të kronometruar.

Ishte koha e komandantëve të lagjeve, e çetave të fëmijëve, që pasditeve i gjeje nëpër qoshka e rrugica, duke luajtur në grup. Ishte koha, kur mamaja nuk të ndiqte pas me pjatën e ushqimit, por me bukë në dorë ti rendje pas shokëve, për të mos humbur lojën e radhës. Shumë pak të rastis të ndeshesh sot, poshtë pallateve, turma fëmijësh që vrapojnë të organizuar në lojëra të ndryshme. Aty-këtu, djem që tentojnë të zhvillojnë një lojë futboll, në trotuarin e ngushtuar dhe rrugën e zënë prej makinave. Ndërsa vajzat, disi më vetmitare, rreken të zhvillojnë ndonjë lojë në cepin e pallatit...

Etiketa që kemi patur pas shpine ka qenë ajo e brezit 'parime dhe normë' dhe për shumë kohë kemi qenë viktimat të telenovelave dhe telebingove.

Ngushëlloheshim pak duke parë "Beverly Hills". Kemi qarë për "Lady Oscar", jemi ngazëllyer me arushin "Tao Tao" dhe me aventurat e Nils Holgersonit, kemi ëndërruar të kishim një skuadër si ajo e "Holly dhe Benjit" dhe jemi futur në dilemat më të thella rreth çështjes nëse "Mila dhe Shiro" në fund fare shkojnë në krevat apo jo.

Jemi të parët që mësuam të punojmë si kamerier nëpër lokale dhe jemi po neve që i kthyem këto lokale në shtëpi të dytë (ose më mirë të parë, pasi ende sot kush rri më shumë se disa orë në shtëpi). Jemi ata që prenotonim ditëlindjet nëpër disko. Jemi brezi që i pari shijoi pub-et e hapura në orën 10 të mëngjesit dhe ata që ende nuk e kuptojnë ku është ndryshimi në Shqipëri mes pub-it dhe diskos.

Gjithmonë na kujtojnë se çka ndodhur para se ne të lindnim, sikur brezi jonë nuk ka asnjë dijeni për ngjarjet historike. Jemi të parët që i pamë prindërit tanë të fusnin para nëpër firmat piramidale dhe mesa duket jemi po ne që u habitëm (ata e morën me qejf) sesi mund të fitohen kaq shumë lekë pa punuar fare. Për faj të më të mëdhenjve, ata që na përsërisin se ne nuk lexojmë aq sa duhet, përjetuam '97, pamë sesi digjej atdheu ynë dhe mësuam që i trembim kaq shumë

Ti, je njëri prej nesh?



popujt e tjerë sa shpesh herë na lenë të mbytemi në det. Ishim ende të vegjël dhe na përsërisnin se paraja çan kudo kur na dhanë makinat e para dhe filluam të falsifikojmë patentat.

Mësuam se çfarë është terrorizmi, por asnjëri nga ne nuk e mban mend rënien e Murit të Berlinit. Kemi gëlçitur se Europa është e mrekullueshme, por e kemi parë edhe të vështirë kur nëpër ambasadë e kufij kemi kaluar net të tëra pasi kompjuterët ishin të prishur.

Jemi brezi i fundit që shijua kasetat, që kur prisheshin i



rregullonim me stilolaps dhe brezi i parë që u hodhëm me krahëhapur nëpër CD-i e internet. Hanim hamburger dhe ne, por të parët mësuam sesi mund të ndryshojë emri edhe pse shija është po ajo (suflaqa, doner etj.). Jemi ne që dilnim nëpër lokale vetëm me lekët për kafe dhe përsëri ndiheshim të pasur kur këto lekë na mjaftonin për të marrë një biter.

Të fundit që pushimet e verës i shijonim nga qershori në shtator dhe të parët që e kuptuan se vera e vërtetë është 15 ditët e para të gushtit. Të fundit që mbajtëm përparësinë në fillore dhe të parët që e kuptuam se veshja e bukur dhe sidomos makina, të japin tjetër pamje përpara realitetit fals dhe mediokër.

Nuk kemi patur celularë. Iknim në shkollë me çanta plot me libra dhe askush nuk na jepte më shumë se një byrek 20 lekësh në drekë.

Mjeti ynë i komunikimit ishte telefoni i shtëpisë dhe kur e bllokoni për orë të tëra të paktën një herë në muaj kishte sherr në shtëpi për faturën telefonike. Ndonjëherë mbyteshim me ëmbëlsira, por nuk ndiheshim mbi peshë dhe as që e kishim idenë se ç' ishte

dieta. Më e shumta që mund të ndodhte ishte që dikush të ishte pak topçe, po puna merrte fund atje. Nga e njëjta shishe pinim 15 veta dhe asnjëri nuk u infektua ndonjëherë.

Kur lidheshim me dikë, pak si me turp, ecnim rrugës dorë për dorë, ndonjëherë edhe putheshim, edhe pse po t' na shihte ndonjë vëlla ose baba thuhej se do t' na vriste. Po ja që mbetëm gjallë dhe të dashuruar..., dikush sot edhe është martuar.

Nuk kishim as 200 kanale televizive, as DVD e as wireless, po gjithsesi kënaqeshim. Nuk kishim fiksimin e adoleshentëve të sotëm për veshjet firmato, sot patologji e të rinjve që nuk shijojnë dot moshën ku janë. Djemtë ishin gjithmonë si të fortë, por kur dashuroheshin bëheshin më të urtë e të ëmbël se qengji, sot nuk di nëse ndjejnë apo e kanë 'hobi'?!

Kemi patur liri, dështime, suksese dhe përgjegjësi... pak e nga pak edhe ne jemi rritur!

Në një bisedë mes dy brezash kuptova sa shumë zhvillimet teknologjike kanë ndryshuar perceptimin për 'ca norma dhe parime', që dukshëm për brezat e viteve 2000 janë utopike apo frazeologjizma klishe që vijnë nga 'mesjeta' e para dy tre dekadave.

Një ditë mbesa pyeti gjyshin e saj: "O gjysh, si ke mundur të jetosh më parë:

Pa teknologji; Pa internet; Pa kompjuter; Pa drone; Pa bitcoin; Pa telefona celularë; Pa Facebook?"

Gjyshi iu përgjigj: "Fiks ashtu si jeton brezi yt sot: Pa njerëzillëk; Pa dinjitet; Pa bashkëpunim; Pa turp; Pa nder; Pa respekt; Pa personalitet; Pa karakter; Pa dashuri; Pa modesti".

Ne, që ju sot na quani "të vjetër", kemi qenë të bekuar dhe provë për këtë është jeta jonë. Kemi luajtur me miq të vërtetë, jo me miq në internet. Kur kishim etje, kemi pirë ujë burimi, jo ujë në shishe plastike. Nuk jemi sëmurrur kurrë kur pinim në të njëjtën gotë me shokët tanë. Nuk i ka ndodhur asgjë këmbëve tona edhe pse ecnim zbathur. Nuk kemi përdorur kurrë përbërës kimik për të qenë të shëndetshëm. I kemi krijuar me duart tona lodrat me të cilat luanim. Prindërit tanë nuk ishin të pasur, por na kanë dhënë aq shumë dashuri, dhe jo video-lojëra që të rrinim urtë. Prindërit tanë nuk divorcoheshin, ata i zgjidhnin gjërat me njëri-tjetrin dhe ne nuk ishim të detyruar të jetonim një ditë me mamën e një ditë me babin. Ne jetonim çdo ditë bashkë. Vërtetë nuk kemi pasur kurrë telefona, DVD, Play Station, Xbox, video-lojëra, kompjuter personal, internet..., por kemi pasur shokë dhe miq të vërtetë. Shkonim tek shtëpia e shokut pa ftuar dhe shijonim bukën e tij me vaj e me sheqer. Kushërinjtë i kishin shtëpitë afër njëri-tjetrit për të shijuar kohën bashkë dhe për t'i u gjendur njëri-tjetrit pranë në çdo hall. Vërtetë jemi në foto bardh e zi, por në ato foto kemi kujtime plot ngjyra. Jemi një brez unik dhe i mirëkuptueshëm, sepse jemi brezi i fundit që ka dëgjuar prindërit dhe jemi brezi i parë që ka dëgjuar fëmijët e tij.

Çdo brez ka 'epokën' e vet të lavdisë dhe ne kemi atë më të rëndësishmen, Demokracinë për të cilën luftuam për ta sjellë dhe shijuar brezat sot.

Detyra e tyre është ta ujisin me kujdes këtë lule të mbjellë mes shumë luftërash.

Spitali Ushtarak, 95 vjet histori njerëzore

Në kohën kur Shqipëria ishte pjesë përbërëse, e pushtuara e Perandorisë Osmane, kohë kur shqiptarët nuk kishin shtetin e për pasojë, as Forcat e tyre të Armatosura, nuk mund të bëhej fjalë as për shërbim shëndetësor e spitalor ushtarak të mëvetësuar. Me gjithë këtë, në hapësirën mbarë shqiptare ishin bërë të njohur emrat e disa mjekëve ushtarakë, që shërbenin në forcat e armatosura osmane, për arsyt e mësipërme. Midis tyre ishte i përmendur doktor Ibrahim Temo nga Struga etj., që nuk mundën të shërbenin në ushtrinë shqiptare, e cila u formua vetëm pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në nëntor 1912.

Shërbimi Shëndetësor është një dukuri e kahershme në skemën organizative të Ushtrisë Shqiptare të pas vitit 1912. Lidhur me këtë shërbim mjaft të domosdoshëm e jetik për këtë ushtri, në një nga dokumentet më të rëndësishëm, të hartuar e miratuar qysh në prill 1913, me titull “Rregullore e Përkohshme e Ministrisë së Luftës”, Vlorë, më 22 prill 1913, ku jepej përbërja e kësaj Ministrie dhe e Shtabit Madhor (Shtabi Madhnuer) të saj, midis të tjerëve përfshihej edhe “Shërbimi Shëndetësor”. Por natyrisht, kjo strukturë, ashtu si dhe disa të tjera, nuk pati kohë të përvijohet e të vihej në jetë tërësisht e plotësisht nga ana e Ministrisë së Luftës e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, për vetë mënyrën dhe shpejtësinë me të cilat u zhvilluan ngjarjet.

Në vitet njëzet-tridhjetë të Shekullit Njëzet, me organizimet dhe zhvillimet që pati Ushtria dhe, në tërësi Fuqitë (Forcat) e Armatosura Shqiptare, edhe ky shërbim erdhi duke u fuqizuar dhe përmirësuar cilësisht. Pikërisht në përbërje të këtij shërbimi tashmë shfaqet edhe një “institucion” me vlera të veçanta, siç është spitali ushtarak.

Njoftimet e para për ngritjen dhe ekzistencën e një spitali ushtarak i përkasin pikërisht këtyre viteve. Kështu e dhëna e parë, e deritashme, e dokumentuar, që bën fjalë dhe dëshmon për ekzistencën e një spitali ushtarak, na vjen nga gjysma e dytë e vitit 1924, është 17 qershori, kur në skemën organizative të Ushtrisë Shqiptare të Qeverisë së F. S. Nolit, për herë të parë përmendet krijimi i një “...Spitali Ushtarak me qendër në Tiranë”. Kurse në vitin 1926, në organikën e përgjithshme të oficerëve të Ushtrisë, me 151 oficerë e aspirantë dhe 23 intendentë, bënin pjesë edhe 5 mjekë ushtarakë.

Por bazat e mirëfillta të mjekësisë ushtarake dhe të shërbimit spitalor ushtarak shqiptar, u hodhën më pas, në periudhën e viteve 1928-1938, kur u ndërmorën disa reformime për riorganizimin dhe përmirësimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Plot katër vite më pas, më 24 qershor 1928 miratohet dhe hyn në fuqi “Ligji i parë organik i Ushtrisë dhe i Gjindarmërisë”, sipas të cilit, duhej të ngriheshin “...nga një spital ushtarak në Tiranë dhe në garnizone të mëdhaja ...”. Garnizonet e mëdha nënkuptonin qendrat e grupeve ushtarake, që përfaqësonin njësitë më të mëdha për Ushtrinë Shqiptare të asaj kohe, të barabarta me një regjiment. Me anën e këtij ligji organik përcaktohej edhe varësia e spitalit nga Komanda e Fuqive Armate, siç quhej atë kohë. Pikërisht në qendrën e njërit prej këtyre grupeve, në Spitalin e Elbasanit shërbente mjeku ushtarak i njohur në atë kohë, major Petraq Popa, që kishte hyrë në Ushtrinë Shqiptare qysh, më 30 prill 1921. Ky mjek i përkushtuar punoi e shërbeu në këtë spital, me një personel të kufizuar, që nga data 5 shkurt 1930.

Në të vërtetë “datëlindja” e Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak



Shqiptar daton më 26 shtator 1929, kur në kryeqytetin shqiptar, Tiranë, ai u ngrit dhe nisi veprimtarinë në një godinë të re dykatëshe, pranë rrugës së Dibrës, tek blloku i sotëm i Spitalit Civil: “Nënë Tereza”. Këtë fakt e ndesh në shumë dokumente dhe botime të kohës, madje edhe në fotografi. Ky spital ishte pronë shtetërore dhe për ndërtimin e tij qenë harxhuar 548.894.88 franga ari. Një gjë e tillë vërtetohet edhe përmes faqeve të “Ligjit për organizimin e Fuqive Armate”, të vitit 1929, sipas të cilit, tek kreu mbi “Fuqitë Tokësore”, pika “Instituta, Stabilimenta e Reparte të ndryshme”, bënin pjesë 4 spitale ushtarakë, një prej të cilëve i “Përgjithshëm”, me qendër në Tiranë.

Ende pa kaluar dy vjet, në qershor 1931, pason një ligj për rregullimin e Ushtrisë Kombëtare, i cili konfirmonte gjithashtu, qenien e një Spitali të Përgjithshëm Ushtarak, në Tiranë. Dy ligje të tillë dolën njëri pas tjetrit dhe më 1934 e 1937 dhe në të dy, në përbërje të Forcave Tokësore të Ushtrisë Shqiptare afirmohej prania e një Spitali të Përgjithshëm Ushtarak në Tiranë. Ky spital bënte madje “shërbimin shëndetësi” nën drejtimin e një mjeku që ishte më i vjetri i garnizonit të kryeqytetit. Spitali varej drejtpërdrejt nga Komanda e Fuqive Armate. Ekzistenca dhe funksionimi i këtij spitali në shërbim të Ushtrisë Shqiptare është i lidhur pazgjidhshmërisht edhe me veprimtarinë e disa mjekëve ushtarakë, të njohur tashmë për botën mjekësore dhe krejt popullin shqiptar, që punuan me përkushtim në të. Një prej tyre, si përfaqësues ndër më të njohurit ka qenë edhe doktor Sinan Imami, i cili figuron në organikën e këtij spitali me gradën toger, qysh më 1933. Krahas tij shërbyen edhe të tjerë si kapiten i klasit të dytë, Dr. Selaudin Mborja (viti 1930); kapiten i klasit të dytë, Dr. Pavli Flloko, (viti 1933); kapiten i klasit të dytë, Dr. Shan Nush Gjoka (viti 1932); toger Avdul Nazmi Skënduli, (viti 1933); toger Spiro Prokop Prosi, (viti 1933); toger Luigj Benusi, (viti 1932); toger Kiço Karajani, (viti 1934); toger Tare Quku, (viti 1938); Dr. Shyqyri Basha, (viti

1938); nëntoger, Dr. Petraq Progri, (viti 1938); nëntoger, Dr. Bahri Kopliku (viti 1938) e të tjerë.

Drejtor i parë i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak, nënkolonel Dr. Ismet Gega, patolog, që u pasua nga Dr. Selaudin Mborja

Fakti që në këtë spital shërbyen disa mjekë të shquar dhe shumë mjekë të tjerë e personel ndihmës, si dhe tema që lidhen me kapacitetin kurues, llojet e shërbimeve, me kualifikimet e personelit, me rregullat e trajtimit e të mjekimit, e të tjera, përbën pa diskutim një objekt me interes për studim të plotë nga historianë ushtarakë dhe pse jo, edhe nga specialistë të mjekësisë ushtarake shqiptare.

Kaq e vërtetë është ekzistenca e këtij spitali të përgjithshëm sa vetë drejtori i tij në vitin 1945, tashmë koloneli Sinan Imami, kishte shërbyer si mjek pikërisht në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak të Tiranës, që nga 1 korriku 1933. Këtë gjë e vërteton më së miri “Lista e përshkallëzimit të oficerëve të përhershëm”, që botohej nga Komanda e Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare pothuajse çdo vit deri më 1939.

Pas agresionit fashist kundër Shqipërisë dhe pas pushtimit të saj, më 7 prill 1939, fati i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak Shqiptar ndoqi atë të vetë Ushtrisë Shqiptare. Ai u bashkua me strukturat e gjithë Forcave të Armatosura të të dy palëve.

Gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare pranë Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare u ngritën e funksionuan disa “spitale partizane”, që kishin një natyrë organizimi dhe veprimi të veçantë, që është e shpjegueshme për kushtet e luftës partizane dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Vullnetare Shqiptare. Kurse pas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj fashistë e nazistë, më 2 shkurt 1945, u ngrit në Tiranë, Spitali i Përgjithshëm (sot Qendror) i Ushtrisë me drejtues (drejtor) të parë ishte pikërisht një nga mjekët e ish-Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak të viteve njëzet-tridhjetë të Shek. XX. Ky ishte mjeku ushtarak, koloneli Sinan Imami, që tani vinte nga radhët e mjekëve të Ushtrisë NÇ. Shqiptare dhe qëndroi si drejtues i këtij institucioni deri në shtator 1973. Më pas, mjekët të shquar kanë qenë drejtues si Dr. Veli Toto, (1973-1989); Dr. Perlat Hodo, (1989-1991); nënkoloneli Dr. Ilir Kajo; nënkoloneli Dr. Mihal Kërçi; koloneli Dr. Esat Duraku; koloneli Dr. Engjëll Mastori; nënkoloneli Dr. Hajri Gërbi; koloneli Dr. Luan Nikollari.

Pas vitit 1945 e deri në ditët tona, shërbimi spitalor ushtarak shqiptar, natyrisht ka njohur përmasa dhe nivele të reja zhvillimi, që përpiqeshin ta mbanin edhe këtë shërbim tepër të rëndësishëm për mbarëvajtjen e Forcave të Armatosura Shqiptare, në një hap me to. Kështu që mund të thuhet se vënia në punë e Spitalit Ushtarak, në atë ditë shkurti 1945, në të vërtetë, mund të quhet ringritje, në kushte të reja, i ish-Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak të viteve '20-'30 të shekullit të shkuar. Ky argument është më pranë të vërtetës historike ushtarake shqiptare.

Të përpiqesh të shkruash dhe të përkujtos me sa më tepër realizëm këto ngjarje, figura apo institucione, për të ndriçuar dhe bërë të njohura ato, është veçse një mënyrë veprimi dhe gjest respekti për veprën e paraardhësve. Njëherësh ai përbën edhe një mesazh vlerësimi dhe njohjeje për ta dhe vetë historinë ushtarake shqiptare, larg skemave shabllone dhe tabu, që i bëjnë të paragjyqeshme ato. Madje, meritë do të ishte zbardhja dhe rindërtimi i plotë në pikëpamje historike i strukturave të tyre dhe përshkrimi e evidentimi i vlerave të personaliteteve të tyre drejtuese.

Më 25 shtator të vitit 1957, plot 67 vjet më parë, u krijua Shërbimi Hidrografik Shqiptar, si një domosdoshmëri për sigurimin hidro-lundrimor të anijeve brenda ujërave tona territoriale. Mirënjohje për përkushtimin dhe devotshmërinë personelit të parë të Shërbimi Hidrografik Shqiptar:

- Komandantin, Kapiten i Rangut II, Arqile PAPADHIMITRI,
- Kapiten i Rangut III, Kiço LATI zëvendëskomandant,
- Shefin e Seksionit të Hidrografisë, Kapiten i Rangut III Mersin SHQYPI
- Shefin e sinjalistikës detare (fenerëve), Kapiten Teufik DIGLI,
- Shefin e Sinoptikës, Kapiten Seit BERISHA.

Gjurmë të këtij shërbimi gjejmë, që në vitet 1878-1890, kur specialistë të Perandorisë Austro-Hungareze përpunuan hartat e para të vendit, të cilat u përmirësuan nga specialistë italianë në vitet 1938-1941. Gjithashtu ata vendosën disa faro-fenerë në pozicionet kryesore të bregdetit shqiptar.

Gjatë kësaj periudhe, Specialistët Hidrografë të SHHSH, bazuar nga të dhënat e matjeve batimerike të bëra me partnerët tanë ndërkombëtare, në bashkëpunim me specialistë të IGJIU-së, prodhuan hartat e para “Paper charts”, për qëllime lundrimore. Për herë të parë në procesin e prodhimit të këtyre hartave u aplikuan standardet ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare Hidrografike (IHO-s). Kjo është dëshmi e rritjes së vetëdijes për rëndësinë që ka vetë Hidrografia dhe hartografimi detar, kontributin e saj në menaxhimin e duhur të “ekonomisë blu” si dhe varësisë njerëzore ndaj këtij ambienti që është vazhdimisht çdo ditë e në rritje.

Hidrografia dhe hartografimi detar, tashmë konsiderohen nga ne, si elementë thelbësorë në zhvillimin e infrastrukturës kombëtare për detin, kjo infrastrukturë përfshin jo vetëm portet e transportin detar por edhe shfrytëzimin e resurseve (pasurive mbi/nën detare) si dhe mbrojtjen e jetës njerëzore, mjedisit e ekologjisë detare.

Pas anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare të Hidrografisë (IHO), dhe në Organizatën Ndërkombëtare të Ndihmës në Lundrim (IALA), Shqipëria bëhet anëtare me të drejta të plota në Komisionin e detit Mesdhe dhe Detin e Zi (Mediterranean and Black Seas Hydrographic Commission (MBSHC)). Tashmë jemi pjesë e vendimmarrjeve në rajonin tonë.

Të qenit pjesë si anëtarë me të drejta të plota në këto Organizata Ndërkombëtare dhe Komisione, i sjell vendit tonë një sërë përfitimesh si:

- Anëtarësimi i Shqipërisë në IHO, e rreshton vendin tonë në krah të vendeve me standarde të larta në fushën e hidrografisë. Një shtet detar pa kapacitete hidrografike nuk ka një pozicion të favorshëm për të përfituar nga asetet dhe burimet e saj detare. Nëpërmjet anëtarësimit në IHO, vendi ynë krijon mundësinë e një zhvillimi të qëndrueshëm në fushën e hidrografisë, e cila ka ndikim në ekonominë e vendit.

- Nëpërmjet anëtarësimit, personel nga Shërbimi Hidrografik, ka përfituar shkollim (trajnim) falas për kryerjen e operacioneve të rilevimit, përdorimin e pajisjeve teknike. Organizata ofron shkollim falas edhe në drejtim të njohurive të veçanta siç është kartografia në funksion të prodhimit të hartave detare apo të delimitimit të kufijve detarë në kuadrin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit. IHO ndihmon shtetet që të rrisin aftësitë e tyre hidrografike ose të vendosë një aftësi të tillë aty ku nuk ekziston. Shqipëria duhet të marrë një rol aktiv në këto organizata, për të qenë dhe përfituese e projekteve, trajnimeve dhe financimeve të rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve hidrografike.

- Shërbimi Hidrografik Shqiptar dhe Forca Detare, në tërësi kanë një rol parësor në sigurimin e tregtisë detare. Produktet dhe shërbimet hidrografike si hartat, udhëzuesit e lundrimit, vjetarët dhe lista e fenerëve, janë të domosdoshëm për njohjen e mjedisit detar, kryerjen e lundrimeve të sigurta dhe zvogëlimin e mundësisë për fatkeqësi detare.

- Anëtarësimi në një Organizatë Ndërkombëtare, i jep Shqipërisë mundësinë për të marrë pjesë në një forum tjetër ndërkombëtar. Megjithëse teknik, pjesëmarrja në këtë forum dhe bashkëpunimi teknik, dy apo shumë-palësh, mund të shërbejë si një kanal komunikimi për thellimin e një bashkëpunimi politik.

- Anëtarësimi në IALA, do të bëjë të mundur që Shqipëria të operojë në fushën e sigurisë lundrimore, në bazë të standardeve të përcaktuara dhe pranuar ndërkombëtarisht.

- Komisioni Hidrografik i Detit Mesdhe dhe Detit të Zi, kryen një funksion mjaft të rëndësishëm, pasi aty diskutohen dhe merren



SPECIALISTËT HIDROGRAFË TË SHHSH, BAZUAR NGA TË DHËNAT E MATJEVE BATIMERIKE TË BËRA ME PARTNERËT TANË NDËRKOMBËTARE, NË BASHKËPUNIM ME SPECIALISTË TË IGJIU-SË, PRODHUAN HARTAT E PARA “PAPER CHARTS”, PËR QËLLIME LUNDRIMORE. PËR HERË TË PARË NË PROCESIN E PRODHIMIT TË KËTYRE HARTAVE U APLIKUAN STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE HIDROGRAFIKE (IHO-S).

vendime, që kanë të bëjnë me çështjet hidrografike në rajonin ku vendi ynë bën pjesë. Puna e këtij komisioni konsiston gjithashtu në nxitjen e gjetjes së zgjidhjeve në rastet e mosmarrëveshjeve mes vendeve anëtare në lidhje me kufijtë detarë dhe pasqyrimin e tyre në hartat detare (në nivel teknik), duke shmangur mbivendosjet dhe përcaktuar saktë zonat e përgjegjësisë. Puna e komisionit ndër të tjera konsiston në koordinimin rajonal mes vendeve anëtare për fushatat e matjeve batimerike, prodhimin e hartave detare, trajnimin dhe projektet e ngritjes së kapaciteteve.

Sigurimi i lundrimit efektiv dhe të pa rrezikshëm në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet mbajtjes të hartografuar të hapësirës detare dhe efikasitetit të sistemit faro-fener, mbeten sfidat tona për të ardhmen.

Prioritetet specifike të dedikuara të punës tonë në vazhdim do të jenë gjithashtu: Përpilimi dhe publikimi i hartave të reja detare (paper charts & elektronike) të bregdetit Shqiptar; Pajisja e bregdetit Shqiptar, me mjete dhe pajisje bashkëkohore të sigurisë hidro- lundrimore si dhe instalimi i fenerëve të rinj detarë, duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e atyre ekzistuese; Ndjekja e konferencave dhe seminareve të organizuara nga Organizata Hidrografike Ndërkombëtare (International Hydrographic Organization (IHO), Organizata Ndërkombëtare e Ndihmës në

Lundrim (International Hydrographic Organization (IALA) dhe nga Komisionet Hidrografike të Detit të Zi dhe Detit Mesdhe (Mediterranean and Black Seas Hydrographic Commission (MBSHC), nga ku Shërbimi Hidrografik Shqiptar mund të përfitojë asistencë tekniko-operative dhe trajnime; Sigurimi i koordinimit të vazhdueshëm me IHO, IALA, pas anëtarësimit të vendit tonë me të drejta të plota në këto organizata si dhe me Komisionin për Detin Mesdhe dhe Detin e Zi,)Mediterranean and Black Seas Hydrographic Commission - MBSHC); Përcaktimi i qartë i bazës ligjore mbi të cilën funksionon Shërbimi Hidrografik Shqiptar, nisur pas anëtarësimit në IHO dhe IALA. Riformulimi i akteve ligjore për mënyrën e pagesës të taksës së sinjalistikës detare në favor të Shërbimit Hidrografik /Forca Detare, si institucioni ligjor dhe përgjegjës për krijimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sinjalistikës detare si dhe krijimi i bazës ligjore dhe përcaktimi i një listë çmimesh për shërbimet dhe punimet që ofrohen nga Shërbimi Hidrografik Shqiptar për palët e interesuara.

Në mënyrë të vazhdueshme nga ana jonë, përgatiten publikime dhe njoftime për lundëtarët, në bashkëpunim me IGJIU-në publikojmë harta detare, rrugëkalimet detare si dhe listat e faro-fenerëve me qëllim përmbytjen e nevojave për një lundrim të sigurt.

Shqipëria në syrin e të huajve

Shqipëria është një vend mbresëlënës, me një histori dhe kulturë diverse. Ajo që e bën të veçantë në sytë e të huajve janë: Toleranca fetare, e cila është bazë themelore e kulturës shqiptare. Edhe pse zyrtarisht Shqipëria është një vend mysliman, ky nuk është një aspekt domethënës i kulturës së tyre. Në Shqipëri ka gjithashtu të krishterë, dhe komunitete hebre, të cilët jetojnë në mënyrë paqësore, duke u kushtuar pak ose aspak vëmendje dallimeve fetare.

Shqipëria është një emër latin, i cili daton që prej kohës së Ilirëve, të njohur si Albanë. Përpara kësaj, vendi njihet si Arbëri dhe banorët quheshin Arbëresh, deri në shekullin e 16, kur vendi mori emrin Shqipëri dhe banorët u quajtën shqiptarë. Termi ka kuptimin si vendi i shqiponjave, e ndërsa banorët, bijtë e shqiponjave.

Simboli ndërkombëtar dhe etnik i Shqipërisë është shqiponja dykrenore, dhe fillimisht u paraqit në një gurë, i cili daton në shekullin 10, në kohën kur nën sundim ishte Principata e Arbrit. Ajo simbolizon heroizmin dhe lirinë e Shqiptarëve.

Gjuha shqipe është e ndarë në dy dialekte, verior i quajtur Gegë dhe jugor i quajtur Toskë.

Ndarja mes njerëzve të cilët flasin këto dialekte është lumi Shkumbin nga Veriu në Jug. Dialekti Gegë flitet gjithashtu nga shqiptarët e Kosovës, Malit të Zi, dhe Maqedonisë veriore, ndërsa dialekti Toskë flitet nga pakica e shqiptarëve në Greqi, Maqedoninë jugore, dhe Italinë jugore.

Edhe pse Shqipëria është një vend i vogël, atje ndodhen 3 qytete të mbrojtura nga UNESCO. Këto janë Berati, Butrinti, dhe Gjirokastra.

Kanuni përmbante një listë me traditat Shqiptare, të cilat u vunë në zbatim nga Lekë Dukagjini në mesjetë. Kanuni nuk është vetëm një listë rregullash, por gjithashtu një libër historik dhe politiko-social. Një nga rregullat primare të Kanunit është besa, e cila konsiderohej si pjesa më e rëndësishme e Kanunit dhe tregon rëndësinë e mbajtjes së premtimeve dhe detyrimeve.

Gjatë kohës së Holokaustit, shqiptarët strehuan të paktën 2000 hebrenj. Në vend që t'i fshihnin ata në pyje, ata u dhanë hebrenjve rroba dhe emra shqiptar dhe më pas i integruan në shoqëri, duke i trajtuar si familje dhe jo si të huaj.

Muzika tradicionale shqiptare është tepër e larmishme dhe ka rrënjët e saj në tingujt dhe trashëgiminë indigjene. Format e poezisë së këndshme epike, muzika popullore dhe instrumenteve të tilla si instrumentet e erës, violinat, lahuta dhe daullja, janë të zakonshme dhe vallëzimi tradicional është shumë popullor. Kur bëhet fjalë për muzikën moderne, Shqipëria dhe diaspora kanë prodhuar disa muzikantë të njohur ndërkombëtarisht si Rita Ora, Dua Lipa dhe këngëtarët e operës Inva Mula, Ermonela Jaho, Samir Pirgu etj.

Çdo vit, më 14 mars, shqiptarët festojnë Ditën e Verës. Kjo festë simbolizon fundin e dimrit, rilindjen e natyrës dhe një përtëritje të mendjes, trupit dhe shpirtit. Fokusi i festivalit është në qytetin e Elbasanit, gjithashtu festohet gjerësisht në Tiranë me festimet e mëdha në rrugë. Përveç kësaj, nga 1 marsi, të rinjtë vendosin një byzylyk tradicional të njohur si verore e cila është bërë nga dy vargjet endur që janë zakonisht të kuqe dhe të bardhë.

Më 14 mars, byzylyku varet në një degë peme për fat të mirë, me shpresën se një dallëndyshe do të përdorë fijen për të ndërtuar follenë e saj. Shqiptarët lëkundin qafën kur duan të thonë jo, dhe tundin kokën kur thonë po.



